



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 24.07.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 7 datë 11/07/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025"

Analiza ligjore:

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Situata aktuale e funksionit: --

Situata financiare : Projekt vendimi propozon qe 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Qershor 2025 , familje 137, me 439.174 lekë, me 5.98% e fondit total. 2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Qershor 2025 janë shpallur fitues, 955 familje, me fond 7.328.326 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 439.699 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndhmes Ekonomike dhe Pak kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut, i mbledhur me datën 24/07/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.7 datë 11/07/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Qershor 2025" paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi  **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj  **Zv.Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Saniye Salja  **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)